



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 47/1 Prot.

Tiranë, më 03.02 2015

VENDIM

Nr. 12, datë 03/02/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, të nenit 31/1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesja Znj. _____ i është drejtuar Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) me ankesën nr.47 prot, datë 14.01.2015 “Për shkelje në mënyrë të përsëritur të të drejtës së saj për informim” kundër Universitetit të Tiranës (UT), Rektorit Z.Dhori Kule, Fakultetit të Shkencave Sociale (FSHS) Dekanit, Z. Theodhori Karaj dhe Këshillit të Etikës të Universitetit të Tiranës (KE të UT-së) Kryetares, Znj. Evis Alimehmeti. Nga shqyrtimi i ankesës konstatohet se ankuesja/ _____ legjitimohet të paraqesë këtë ankesë, në përputhje me pikën 2/b të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Rezulton se, në datë 29.12.2014, ankuesja në cilësinë e kërkueses i është drejtuar me kërkesë të tre drejtuesve të autoriteteve të lartpërmendura për ti rikujtuar mbi kërkesat e saj të depozituara në datë 5.11.2014, 7.11.2014 dhe 12.11.2014 të marra nëpërmjet dokumenteve postare, përkatësisht “lajmërim marrje” i Postës Shqiptare, datë 5.11.2014, “lajmërim marrje” i Postës Shqiptare, datë 10.11.2014, “lajmërim marrje” i Postës Shqiptare, datë 20.11.2014, bashkëlidhur ankesës.

Nëpërmjet kërkesës së datës 29.12.2014, e cila ripërsërit kërkesën e datës 5.11.2014, ankuesja ka kërkuar nga FSHS, **1) Rregulloren e funksionimit të Këshillit të Profesionalistëve sipas përcaktimit të nenit 41, pika 5 e Statutit të UT-së, 2) Rregulloren e FSHS-së, 3) Dokumentacionin e prodhuar në funksion të procedurës së iniciimit të verifikimit të doktoraturës së ankueses deri në definimin e shkresës nr.21 prot, datë 3.09.2014.**

Nëpërmjet kërkesës së datës 29.12.2014 e cila ripërsërit kërkesën e datës 7.11.2014 dhe 12.11.2014, ankuesja ka kërkuar nga Rektori i UT-së, **1) Kopje të njehsuar me origjinalin të dokumentacionit të prodhuar në funksion të procedurës së iniciimit të verifikimit të doktoraturës së :** *deri në definimin e revokimit të saj nëpërmjet shkresës nr.21, datë 3.09.2014* **2) Kopje origjinale të vendimit nr.171, datë 29.10.2014 të Rektorit Z. Dhori Kule, sipas të cilës është vendosur zgjidhja e menjëherëshme e kontratës së punës dhe largimi i saj nga puna **3) Kopje origjinale të vendimit nr.169, datë 28.10.2014, për revokimin e gradës shkencore "Doktor"** **4) Gjithë praktikën e njoftimit të mbledhjeve të Këshillit të Profesorëve dhe procesverbaleve të mbajtura gjatë tyre në funksion të vendimit nr.55, datë 8.09.2014 të tij **5) Çdo dokument (njoftime dhe procesverbale të mbajtura) të prodhuar nga grupi i punës të ngritur në zbatim të Urdhërit të Brendshëm të Rektorit të UT-së nr.12, datë 25.09.2014 "Për përfundimin e verifikimeve të KP-së të FSHS-së në disertacionin e******

Nëpërmjet kërkesës së datës 29.12.2014 e cila ripërsërit kërkesën e datës 12.11.2014, ankuesja ka kërkuar nga Znj. Alimehmeti, Kryetare e Këshillit të Etikës së UT-së, **1) "Kopje të njehsuar me origjinalin me vulë sekretarie të njoftimeve për mbledhje të anëtarëve të Këshillit dhe të Protokollit të mbledhjes ose mbledhjeve të Këshillit të Etikës, që janë mbajtur për të shqyrtuar materialet e përcjella nga Rektori për çështjet e gradës së saj **2) Dy vendime që Këshilli i Etikës ka marrë në shqyrtim të materialeve të përcjella nga Rektori i UT-së për çështje të gradës së saj **3) Të shkresës datë 17.09.2014 "Shqyrtim i vendimit të Këshillit të Profesorëve të FSHS-së përcjellë nga Rektori i UT-së", të Këshillit të Etikës** **4) Përgjigje kërkesës së saj për të cilën pretendon se sipas konfirmimit me email nga adresa e Znj. Alimehmeti në datë 2.10.2014 është përgatitur por nuk është vënë në dispozicion të ankueses.******

Nëpërmjet shkresës së datës 30.12.2014, ankuesja i është drejtuar me kërkesë Dekanit të FSHS-së Z. Karaj për ti vënë në dispozicion **1) Kopje të njehsuar me origjinalin të shkresës nr.890 prot, datë 25.11.2014 me lëndë "Për informimin e stafit pedagogjik dhe studentëve".** Edhe kjo kërkesë rezulton e marrë nga autoriteti publik nëpërmjet dokumentit "lajmërim marrje" i Postës Shqiptare, datë 6.01.2015. Në të gjithë ankesat është përcaktuar qartë edhe forma e kërkuar e dokumentacionit, në përputhje me nenin 14 "Mënyrat e dhënies së informacionit", të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri bazuar në pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", pasi verifikoi faktet dhe bazën ligjore të ankesës, vëren se, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 "për të drejtën e informimit", Autoritetet publike/Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Këshilli i Etikës pranë Universitetit të Tiranës nuk kanë trajtuar kërkesën për informim brenda afatit 10 ditë pune nga dorëzimi i saj.

Për të gjithë kërkesat rezulton se nuk është marrë përgjigje. Nga provat e administruara vërehet se çdo dokument i kërkuar i referohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ankueses, çka tregon se ato përmbajnë të dhëna personale të saj. Në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, informacioni/dokumentacioni i kërkuar nuk ndalohej në dhënien e tij pasi kërkohet nga vetë subjekti i të dhënave që i përket ato/të dhënat. Gjithashtu, informacioni/dokumentacioni i cili mund të identifikojë edhe drejtuesit e autoriteteve publike të cilëve i kërkohet ai/dokumentacioni apo edhe të tjerë persona publik, për sa kohë ata

janë të tillë, për çdo veprimtari të kryer në përmbushje të detyrave të tyre funksionale, të dhënat personale të tyre në përputhje me pikën 4/a të nenit 4 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, nuk i nënshtrohen masave mbrojtëse të parashikuara në këtë ligj dhe për rrjedhojë informacioni nuk mund të refuzohet nën këtë arsyetim. Është detyrim i çdo autoriteti publik që në rast të depozitimit të çdo kërkesë për dhënie informacioni/ dokumentacioni, të trajtojë atë në përputhje me pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Është detyrë e çdo autoriteti publik që gjatë trajtimit të kërkesës të identifikojë nëse informacioni apo një pjesë e tij mund të jenë ose jo pjesë e informacionit publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe nëse informacioni/dokumentacioni i kërkuar mund të refuzohet sipas ndonjërit prej parashikimeve të bëra në nenin 17 të këtij ligji. Në rastin konkret parashikimi i bërë në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 17 është tërësisht i përjashtuar pasi të dhënat në dokumentacionin e kërkuar i përkasin ankueses dhe nuk mund të refuzohen. Nga institucionet ndaj të cilave është kërkuar dokumentacioni rezulton se, nuk janë trajtuar kërkesat e ankueses dhe për rrjedhojë nuk është zbatuar asnjë prej dispozitave të cituara në këtë arsyetim. Në përputhje me pikën 4 të nenit 15 mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të përcaktuara në këtë dispozitë konsiderohet refuzim dhe në përputhje me shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, “Refuzimi i dhënies së informacionit në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji dënohet me 150.000 deri në 300.000 lekë”. Në zbatim të pikës 3 të nenit 18, përgjegjësia për këtë kundërvajtje administrative është e koordinatorit. Për mospërmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 10 pika 1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, mos caktimi i koordinatorit nga titullari i autoritetit publik bën që përgjegjësia të mbetet mbi këtë të fundit.

Në përfundim, nga provat e depozituara rezulton se ankesa e shtetasës
bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

është e

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 14 dhe pikës 5/b/ç të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr 47, datë 14.01.2015 të _____ kundër autoritetit publik/ Rektoratit të Universitetit të Tiranës, autoritetit Publik /Fakultetit të Shkencave Sociale dhe autoritetit Publik/Këshillit të Etikës së Universitetit të Tiranës.
2. Urdhërimin e autoritetit publik/Universitetit të Tiranës për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar në shkresën e datës 12.11.2014 (e përsëritur me shkresën e datës 29.12.2014) deri në datë 10.02.2015, sipas formës së kërkuar.
3. Urdhërimin e autoritetit publik/Fakultetit të Shkencave Sociale për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar në shkresën e datës 5.11.2014 (e përsëritur me shkresën e datës 29.12.2014) deri në datë 10.02.2015, sipas formës së kërkuar.

4. Urdhërimin e autoritetit publik/ Këshillit të Etikës së Universitetit të Tiranës për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar në shkresën e datës 12.11.2014 (e përsëritur me shkresën e datës 29.12.2014) deri në datë 10.02.2015, sipas formës së kërkuar.
5. Urdhërimin e autoritetit publik/Fakltetit të Shkencave Sociale për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar në shkresën e datës 30.12.2014, (shkresë nr.890 prot, datë 25.11.2014 me lëndë “Për informimin e stafit pedagogjik dhe studentëve”) deri në datë 10.02.2015, sipas formës së kërkuar.
6. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 3.02.2015.

Besnik DERVISHI

